

Statistikat e transportit

Shkurt, 2018

Tiranë, më 27 Mars 2018: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Shkurt 2018 është 345 mijë ton, duke u rritur 25,6 %, krahasuar me Shkurt 2017.

Në dymujorin e parë 2018, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 646 mijë ton, duke u rritur me 31,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 661 mijë ton - kilometër, duke u ulur me 48,7 % krahasuar me Shkurt 2017.

Për dymujorin e parë e 2018, ky volum është 1.422 mijë ton- kilometër, duke u ulur me 27,4 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

Periudha	Det ton	Hekurudhë 000/tkm	Ajër* ton
Shkurt - 2017	274.455	1.289	167
Shkurt - 2018	344.658	661	167
Ndryshimi vjetor (%)	25,6	-48,7	0,0
Janar - Shkurt 2017	492.354	1.958	324
Janar - Shkurt 2018	646.207	1.422	349
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	31,2	-27,4	7,7

Përfshin mallrat dhe postën

Në muajin Shkurt 2018, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 167 ton.

Në dymujorin e parë të 2018, me ajër janë transportuar 349 ton mallra, duke u rritur 7,7%, krahasuar me të njëjtën periudhë 2017.

Numri i fluturimeve të kryera, në Shkurt 2018, është 1.554, duke shënuar një ulje me 0,9%, ndaj Shkurt 2017.

Për publikim 27/03/2017

Në dymujorin e parë të 2018, janë kryer 3.606 fluturime, duke u rritur me 6,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 2 Treguesit e transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore	Numri i fluturimeve	Numri mbikalimeve
Shkurt - 2017	15	1.568	7.435
Shkurt - 2018	17	1.554	7.650
Ndryshimi vjetor (%)	13,3	-0,9	2,9
Janar - Shkurt 2017	15	3.374	15.472
Janar - Shkurt 2018	17	3.606	16.408
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	13,3	6,9	6,0

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare në Shkurt 2018 është 36.393 pasagjerë, krahasuar me Shkurt 2017, ky tregues është ulur 15,7 %.

Në dymujorin e parë 2018, kanë udhëtuar me linjë detare 103.688 pasagjerë, duke u ulur me 13,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në dymujorin e parë 2018, transporti ajror i pasagjerëve zë 80,1 % të transportit gjithsej. Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në dymujorin e parë 2018 është 368.706 duke u rritur me 11,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Hekurudhë	Det	Ajër
Shkurt - 2017	48	43.176	140.368
Shkurt - 2018	2.063	36.393	154.515
Ndryshimi vjetor (%)	4.197,9	-15,7	10,1
Janar - Shkurt 2017	171	119.160	332.127
Janar - Shkurt 2018	4.406	103.688	368.706
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	2.476,6	-13,0	11,0


Eksporti/Importi i mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Shkurt 2018, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 70 mld lekë dhe 57,4 % e tyre u transportua me det.

Eksportet e mallrave

Në Shkurt 2018, mallrat e eksportuara me det zënë 64,9 %, me rrugë 30,0 % dhe me ajër 0,9 %. Mallrat e eksportuara me rrugë, në Shkurt 2018, janë rritur me 10,4 % dhe me det janë rritur 17,3 %, krahasuar me Shkurt 2017.


Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Shkurt 2018



Importet e mallrave

Në Shkurt 2018, mallrat e importuara me det zënë 53,6 %, me rrugë 41,8 % dhe me ajër 2,6 %. Mallrat e importuara me det, në Shkurt 2018, janë rritur me 12,4 %, krahasuar me Shkurt 2017.

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Shkurt 2018



Metodologji

Përkufizime:

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007) është një nomenklaturë mallrash e përdorur kryesisht për statistikën e transportit

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/reth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë